

**V E N D I M**  
**Nr.563, datë 13.10.2001**

**PËR DHËNIE NDIHME TË MENJËHERSHME PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "d" të pikës 2 të nenit 64 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit" dhe të neneve 11 e 17 të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 "Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Paraardhësve, pasardhësve ose personave që organizojnë funeralin dhe paguajnë shpenzimet e varrimit të ish-punonjësit aktiv të Policisë së Shtetit, në dispozicion, të pezulluar, me pagesë kalimtare, në pension, student, kursant ose ushtar dhe punonjësve civilë, efektivë në strukturat e Policisë së Shtetit u jepet ndihmë e menjëhershme për përballimin e shpenzimeve shtesë të varrimit, si më poshtë vijon:

a) Gjashtë paga referuese mujore të muajit të fundit për ish-punonjësit aktivë të Policisë së Shtetit;

b) gjashtë paga referuese mujore të muajit të fundit të dispozicionit për ish-punonjësin në dispozicion;

c) gjashtë paga referuese mujore të muajit të fundit për ish-punonjësit e pezulluar;

d) gjashtë paga referuese mujore të funksionit më të ulët të punonjësit të Policisë për ish-punonjësit me pagesë kalimtare;

e) gjashtë paga referuese mujore të funksionit më të ulët të punonjësit të policisë për ish-pensionisët, për burrat me vjetërsi shërbimi jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet dhe për gratë jo më pak se dymbëdhjetë vjet;

f) gjashtë paga referuese mujore të funksionit më të ulët të punonjësit të Policisë për ish-studentët;

g) gjashtë paga referuese mujore të funksionit më të ulët të punonjësit të Policisë për ish-kursantët ose ish-ushtarët;

h) gjashtë paga mujore për ish-punonjësit civilë efektivë në strukturat e Policisë së Shtetit.

2. Personat përfitues sipas pikës 1 të këtij vendimi përcaktohen me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**